



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 983/1 Prot.

Tiranë, më 23.06.2025

V E N D I M

Nr. 151, Datë 23.06.2025

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është regjistruar ankesa nr. 234, datë 13.11.2024¹, e paraqitur nga z. E.M, si përfaqësues i fëmijës së tij A.M, kundër Shkollës 9-vjeçare “Sulë Harri”, Elbasan, me pretendimin për diskriminim për shkak të “gjendjes shëndetësore” dhe “çdo shkak tjetër”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës dhe me e-mail-in datë 25.11.2024, subjekti ankues, në mes të tjerash informon se: *“Me hapjen e aplikimeve në e-albania për regjistrimin e fëmijës në klasë të I-rë, kam bërë regjistrimin e fëmijës tim A.M, në shkollën 9-vjeçare “Sulë Harri”. Me datë 09.09.2024, si çdo fëmijë edhe djali ynë filloj shkollën. Në asnjë moment djali nuk ka pasur probleme me ambientimin duke ditur që fëmijët kanë pak probleme kur fillojnë klasën e I-rë. Problemet kanë filluar më pas. Në mënyrë të përmbledhur do të shpjegoj me data faktet sesi ndaj djalit tim është përdorur një formë e dhunës psikologjike në formën e ngacmimit masiv të një personi në grup “mobbing”. Kjo ka ndodhur në një mjedis shkolle dhe është një lloj abuzimi emocional ku një pjesë e prindërve/nxënësve e kanë ngacmuar djalin tim me qëllime të*

¹ Ankesa është plotësuar me informacionin e dërguar me e-mail-in datë 25.11.2024.

caktuara, për ta detyruar atë të largohet nga shkolla. Komunikimin tonë, drejtoresha ja tregon dhe prindërve të tjerë të klasës, që për hir të së vërtetës ishin shkaktarët kryesor të kësaj situatë, pasi disa prindër që ishin dhe kushërinj me njëri-tjetrin, kishin vendosur të largonin djalë tim nga klasa dhe për këtë i bënin presion mësueses dhe më pas drejtoreshës.

Fatkeqësisht, djali përjetoj traumë dhe nuk pranonte në asnjë mënyrë të shkonte më në atë shkollë, pas ngjarjeve të mëposhtme.

Data 14.10.2024: Merret nusja në telefon nga mësuesja, e cila i thotë: “Hajde merre djalë se nuk po më lë të zhvilloj mësimin, bën zhurmë, etj”. Nusja dërgon babain tim dhe ai e merr djalë nga shkolla.

Data 15: Sërish mësuesja i thotë nuses “Hajde merre”, sepse është e njëjta situatë. Shkon dhe e merr gjyshi pa mbaruar orët e mësimit në orar. Mbasdite e takon nusja dhe shkojnë në shtëpi, sepse ne e dërgonim te mësuesja për mësim pasdite në shtëpinë e saj, bashkë me disa fëmijë të tjerë sipas orarit. Mësuesja i thotë nuses “Nuk e mbaj dot, diskutoje me E.M, sepse nuk e menaxhoj dot; bën rrëmuje, etj. Më mirë mos e sill nesër, të vijë E.M dhe të vendosni”. Nusja më thotë për këtë situatë, e shqetësuar. Ndërkohë, unë isha në Danimarkë, në një kongres.

Data 16: Djali nuk shkon në shkollë, për shkak të situatës emocionale-psikologjike të krijuar një ditë më parë.

Data 17: Pasi komunikoj me djalë, e bind që të shkojë në shkollë. E dërgoj vetë djalë. Pa kaluar një orë, më merr në telefon mësuesja dhe thotë “Hajde merre se nuk më lë të bëj orën e mësimit”. Më dërgon këtë mesazh, dhe unë shkoj e marr djalë. Mësuesja e kishte marrë në tabelë dhe po shpjegonte sikur djali ishte “i lidhur në zinxhirë”. E marr në korridor, djali i qetë, dhe më thotë vetëm “Do ikim, babi?”. I shpjegoj që duhet të kthehet në mësim dhe të vazhdojë mësimin. I trokas derës së klasës, vjen mësuesja dhe nuk reagon, vetëm rri. I them që të kthehet djali në mësim, por nuk reagon. Djali donte të ikte, kështu që e mora.

Pasi e dërgoj dhe e qetësoj djalë në shtëpi, i dërgoj mësueses mesazh që të diskutoj me të situatën e pazakontë të krijuar, por ajo nuk më kthen përgjigje. Nusja më pas merr drejtoreshën dhe i thotë që mësuesja e thërret që ta marrë djalë, që do të thotë “merre djalë, do ta largojë”. Drejtoresha e thërret dhe flet me mësuesen. Mësuesja nxeht që ne i thamë drejtoreshës dhe merr nusen në telefon dhe i thotë “Faleminderit që më kuptove. Hajde merr sendet e djalit, se ka lënë në klasë kuletën, dhe ne jemi miq, do pimë kafe si motra, etj”. Unë mërzitem nga këto fjalë. Të nesërmen, e çoj djalë në shkollë, por pashë një reagim jo të mirë nga mësuesja, sepse priste që unë të mos e çoja më. Nuk i kishte caktuar vend për të ndenjtur. Djali desh të ulej në bankën ku qëndron gjithmonë dhe ajo largoi një fëmijë që e kishte sjellë në atë bankë, që të ulej djali i qetë. Të nesërmen më merr mësuesja në telefon, por unë isha i zënë dhe shkova e mora në drekë.

Data 18: Drejtoresha më thotë: “Hajde të bisedojmë për të ndërhyrë psikologët në orë të mësimit, të futen ta ndjekin, të vëzhgojnë për 2 javë”. Dakord, i them unë dhe shkoj rreth orës 10. Takohem me drejtoreshën dhe psikologët: ato kishin hyrë në orën e mësimit dhe më thonë disa

rekomandime: “është fëmijë i llastuar, bindet, nuk është i dhunshëm”. Gjatë bisedës, sanitarja hap derën e drejtorisë dhe thotë: “A.M po bën namin aty poshtë”. Unë acarohem dhe i them drejtoreshës “Çfarë janë këto skema kështu?”. Unë e sjell djalin në shkollë në orën 8 dhe do ta marr në 11:30 ose 12:20, sipas orarit të mësimi te dera e shkollës.

Komunikimin tonë, drejtoresha ia tregon dhe prindërve të tjerë të klasës, që për hir të së vërtetës ishin shkaktarët kryesor të kësaj situatë, pasi disa prindër që ishin dhe kushërinj me njëri-tjetrin, kishin vendosur të largonin djalit tim nga klasa dhe për këtë i bënin presion mësueses dhe më pas drejtoreshës.

Data 22: Dy prindër dalin dhe bëjnë shumë rrëmujë në korridor, duke më thënë: “Pse ke thënë kështu, ti ke përgjegjësi, hajde rri në klasë”. Njëri më tha: “Fëmija im s’ka fjetur, sepse e ka trembur A.M”. Një tjetër më tha: “Shiko çfarë do të bëj unë ty, etj”. Me datë 22, futen psikologët dhe menaxhojnë situatën në klasë. Nga komunikimi verbal me psikologun mu shpreh se: “Nuk ka asgjë shqetësuese, thjesht fëmijët e tjerë krijojnë situata, që djalit tënd nuk i pëlqejnë për shkak të karakterit të tij”.

Data 23: Grupi prindërve (kushërinjtë) bëjnë sërish sherr me mua, siç e thashë më parë me qëllimin e vetëm, që unë të largoj djalit nga ajo shkollë.

Data 24: Një nga prindërit, S.H, futet në klasë gjatë orës së TIK-ut dhe e kërcënon djalit. I kërkoj drejtoreshës të takohem me mësuesen e TIK-ut për këtë çështje, por nuk më nxjerrin mësuesen. I them drejtoreshës: “Thuajti të ketë kujdes S.H, mos t’i afrohet djalit, sepse po dola para asaj, mos bëj ndonjë skandal”. I them drejtoreshës: “Thuaja vetë”.

Me datë 25, në mëngjes, grupi i prindërve ishin mbledhur dhe rrinin në korridor, takuan drejtoreshën për këtë rast dhe kanë bërë edhe një video djalit. Ky ka qenë dhe momenti fundit ku djalit nuk pranonte absolutisht të shkonte në shkollë për shkak të traumës (kërcënimit dhe videos) që kishte kaluar një ditë më parë.

Më pas kam përcjellë shqetësimin tim pranë ZVAP Elbasan, e cila ngriti një Komision për të vlerësuar rastin, por djalit nuk pranonte të shkonte më në shkollë. Komunikimi me mësuesen, drejtoreshën e shkollës dhe ZVAP Elbasan ka qenë verbal.

Së fundmi, dua të theksoj se gjatë periudhës që mësuesja më ngrinte shqetësimin se fëmija mund të ketë probleme psikologjike, i kam bërë djalit vizitë të specializuara pranë mjekut neuro-pediatër, i cili pas vizitës nuk diagnostikoi ndonjë sëmundje të djalit. Gjithashtu, djalit pas situatave të krijuara në shkollë, nuk pranonte në asnjë mënyrë të shkonte në shkollë, ndaj e kam trajtuar me psikologe, e cila diagnostikoi se djalit kishte kaluar një traumë në shkollë. Gjatë periudhës që trajtohej me psikologun për të sjellë dëshirën tek ai për shkollën, e kam dërguar në një shkollë private, e cila gjatë ditëve që djalit ka qëndruar me orë të caktuara, nuk më ka raportuar asnjë sjellje problematike të tij”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Neni 5, i ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, parashikon ndalimin e diskriminimit për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji. Sipas këtij neni ndalohet gjithashtu mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, të një ankimi ose procedure, si dhe çdo formë tjetër sjelljeje, që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Në bazë të nenit 7, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës së depozituar pranë Komisionerit, u konstatua se ajo kishte paqartësi, në lidhje me shkakun e pretenduar dhe lidhjes shkakësore, ndërmjet trajtimit më pak të favorshëm dhe shkakut të mbrojtur.

- Për këtë arsye, me e-mail-in, datë 18.11.2024, inspektori i çështjes, ka kërkuar nga subjekti ankues që të plotësojë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm.

Subjekti ankues, me e-mail-in datë 25.11.2024, dërgoi informacionin e kërkuar.

- Me shkresën nr. 1552/1, datë 03.12.2024, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar parashtrime nga subjektet kundër të cilëve është paraqitur ankesa, lidhur me pretendimet e subjektit ankues, si dhe ka kërkuar dokumentacionin si më poshtë:

Nga ana e Shkollës 9-vjeçare “Sulë Harri”:

- Argumentimin Tuaj, për të gjitha pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.
- Shpjegime dhe kopje të plotë të procedurës së ndjekur nga mësuesja e klasës, lidhur me trajtimin e shqetësimit të ngritur nga z. A.M dhe masat e marra.
- Informacion dhe kopje të dokumentacionit mbi masat e marra nga Drejtoria e shkollës për trajtimin e situatës dhe asistimin e fëmijës me shërbimin e psikologut.

ZVAP Elbasan:

- Informacion dhe dokumentacion lidhur me procedurën e ndjekur nga ZVAP Elbasan për trajtimin e ankesës të z. A.M.

Me shkresën nr. 31, datë 16.12.2024, Shkolla “Sulë Harri”, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Datë 17.10.2024, e enjte. Rreth orës 11.30 më telefonon prindi E.M, nëna e nxënësit, klasa I-a, për të më vënë në dijeni se: “Prej 3-4 ditësh jam e shqetësuar sepse mësuesja e djalit, Sh.B, më lajmëron që ta marr djalin më herët, ngaqë shfaq sjellje problematike në klasë”. Ajo tha se: “kjo situatë më ka mërzitur aq shumë, sa do të largoj djalin nga shkolla”.*

I them nënës së djalit se “rreth orës 09.00, unë dhe nëndrejtoresha e arsimit fillor (AF) e kemi takuar babain E.M dhe djalin në korridorin e katit të parë”. E kam pyetur se “pse po e merrte djalin aq shpejt”, ndërsa ai është shprehur se “djali është i sëmurë dhe kam ardhur ta marr më shpejt”.

Gjithashtu i them nënës se “Do flas me mësuesen për këtë situatë”. Në përfundim të mësimit të klasës I-a, e njoh mësuesen me ankesën e prindit E.M.

Mësuesja thotë se e ka njoftuar nënën që “të vijë të marrë djalin se ai ishte i sëmurë, vetë prindi ma ka kërkuar ta njoftoj nëse ndihet keq djali apo shfaq acarim, meqë ka filluar mjekim me pompë e kjo, mund të ndikonte për një sjellje të acaruar”.

Duke qenë se ka kundërshti të dukshme në çfarë secila deklaron, pas bisedës me mësuesen rreth orës 13.00, i propozoj nënës që “nesër ju presim si prindër në shkollë që të bisedojmë nga afër” dhe i them “që është mirë që edhe SHPS-ja e shkollës të vihet në dijeni dhe të japë ndihmën e vet”.

Prindi fillimisht heziton për shërbimin psikosocial (SHPS). E sqaroj që “SHPS në shkollë ndihmon fëmijët përmes lojërave psikosociale, ndërhyrjeve të veta që ata të përshtaten, sepse nga përvoja që kemi, kryesisht fëmijët e klasës së parë mezi përshtaten ose lodhen shpejt dhe e shprehin këtë në sjelljen e tyre”.

Nëna thotë se “nesër (referuar datës 18 tetor) nuk vijnë dot, por mund të vijmë të hënë (referuar datës 21 tetor) ose të martën dhe atëherë do të diskutojmë dhe për SHPS”.

Datë 18.10.2024, e premte. Nuk kam kontaktuar me asnjë nga prindërit e nxënësit në këtë datë, duke qenë se nëna ma kishte thënë që në komunikimin tonë të datës 17, se të nesërmen (pra data 18) nuk vinin dot në shkollë. Gjithashtu dhe prindërit e nxënësit nuk më kanë kontaktuar në datë 18 tetor.

As me SHPS nuk janë takuar në këtë datë, sikurse shkruan prindi në ankesën e tij, sepse nuk e kisha referuar rastin në SHPS, duke respektuar kërkesën e nënës që të diskutojmë për SHPS, kur të vinin në shkollë.

Propozimin për ndërhyrje të SHPS së shkollës ia kam thënë nënës në datë 17, jo babait, siç shprehet ai, sepse babain E.M nuk e kam takuar e as nuk kam komunikuar, që nga mëngjesi i datës 17, kur mori djalit nga mësimi rreth orës 09.00.

Nuk kam kontaktuar me asnjë prind të klasës I-a, në këtë datë dhe nuk më ka kontaktuar asnjë prind i klasës I-a, ashtu si pretendon prindi, lidhur me ngjarjen e kësaj date në paragrafin 2, data 18, që sipas tij, komunikimin që paskam pasur unë si drejtuese me E.M ua kam treguar prindërve të tjerë.

Datë 21.10.2024, e hënë. Unë, si drejtuese realizoj një orë monitorimi lidhur me cilësinë e mësimdhënies në klasën I-a, për lëndën e Abetares, si dhe për të parë nga afër klimën në klasë. Nxënësi A. M mungonte. Mësimi u zhvillua normalisht, klima në klasë shumë e qetë.

As të hënë nuk kam pasur komunikim me prindërit.

Nuk kam pasur asnjë kontakt, apo telefonatë me asnjë nga prindërit e klasës në këtë ditë që të më ngrinte ndonjë problematikë lidhur me klimën në klasë.

Datë 22.10.2024, e martë. Ngjarja sipas argumentimit tim është si më poshtë:

Babai i djalit, në datë 22, vjen në drejtori rreth orës 08.15, dhe shprehet se “jam i gatshëm për bashkëpunim me SHPS, por fëmija të ndiqet vetëm në klasë dhe të mos merret në zyrën e SHPS. I kam bërë djalit për merakun tim si prind një kontroll psikologjik...”. U shpreh se “jam i gatshëm të vij në çdo moment”. Prindi kërkoi që për çdo gjë lidhur me djalit të vihem unë vetë personalisht në dijeni dhe jo nusja, se ka fëmijë të vogël, ka pasur nënën e saj të sëmurë këto kohë dhe nuk dua të shqetësohet.

Pas miratimit të tij për SHPS, sapo prindi largohet, vura në dijeni për rastin SHPS. SHPS menjëherë ndjek rastin duke realizuar orë vëzhgimi në klasë. I kërkoj nëndrejtoreshës që ndjek AF, të jetë në kontroll të situatës, për të qenë të gjithë bashkë, në mbështetje si nxënësin ashtu dhe për nxënësit e tjerë.

Prindi me mesazh më dërgon përgjigjen e kontrollit duke u shprehur se “mund ti hynte në punë SHPS-së”. Interesohem për djalin. I komunikoj, se “herë është i acaruar, herë më i qetë”.

I kërkoj prindit që kur të vijë të marrë djalin në përfundim të mësimit, të takojë SHPS për të diskutuar, si do e vazhdojmë punën e përbashkët. Prindi më thotë se mund të vij menjëherë.

Nga SHPS i komunikohet se nga një vëzhgim i parë “djali nuk ndjek mësimin, dëshiron të bëjë atë çfarë ai do, ngacmon shokët, ka nevojë për strukturim të sjelljes dhe do të vëzhgohet për 2 javë, për të kuptuar problematikën”.

Gjatë bisedës me mua nëndrejtoreshën dhe me SHPS prindi tha se “nuk e di pse djali po e shfaq këtë sjellje këtë javë, në shtëpi djali kalon kohë me videolojërë, ndihet pak xheloz për vëllain e vogël, në parashkollor është ndier i përkëdhelur, shkollën nuk është se e ka pasur me shumë dëshirë, ka disa ditë që përdor pompë dhe kjo ndikon tek sjellja e acaruar e këtyre ditëve”.

I kërkoj që të zhvillojmë edhe një bisedë me mësuesen që të koordinoheni, por shprehet se “do të komunikoj vetë me të”.

Sa i takon episodit me punëtoren e shërbimit, ajo hyri për të kërkuar psikologun, sepse e kërkonte mësuesja, ngaqë djali ishte i acaruar dhe disa fëmijë qanin.

Prindit i kërkohet ndjesë për atë ndërhyrje. Punonjësja sociale shkon në klasë, kurse psikologja qëndron në drejtori me prindin dhe me mua. Nëndrejtoresha del për të ndjekur situatën.

Prindi thotë se “do të marr djalin në 11.30, sepse është detyrë e mësueses ta mbajë fëmijën deri në fund të mësimit. Në fakt askush nuk ia kërkoi ta merrte para kohe, sepse kur i komunikuam, i thamë prindit të vinte për takim kur të merrte djalin nga shkolla.

Nuk kam kontaktuar me asnjë prind të klasës I-a në këtë datë dhe nuk më ka kontaktuar asnjë prind i klasës I-a.

Datë 23.10.2024, e mërkurë. Në argumentimin tim, ngjarjet e datës 23.10.2024 janë si më poshtë:

Nxënësi ka ardhur në mësim. Mësuesja e klasës Sh.B, njofton në drejtori se në përfundim të orës së anglishtes, mësuesja e anglishtes i ka shprehur shqetësimin se “Nxënësi A. M ka bërë zhurmë gjatë orës, bërtiste, ngacmonte shokët, hapte ushqimin, etj”.

Gjithashtu mësuesja e klasës shprehet se prindi nuk po tregohet bashkëpunues për të komunikuar me të.

Gjatë orës mësimore vijuese është ndërhyrë nga SHPS për të rregulluar klimën në klasë, meqë djali vazhdon shfaq acarim, ngacmon shokët, disa prej të cilëve qajnë.

I është kërkuar takim prindit nga SHPS, por ai është shprehur se do të vijë të nesërmen në mëngjes. Ndërkohë, SHPS më vë në dijeni se mësuesja ka filluar të zbatojë udhëzimet e dhëna nga SHPS.

Datë 24.10 2024, e enjte. Në argumentimin tim, ngjarjet e datës 24 janë si më poshtë:

Rreth orës 8.10 dëgjoj zëra që vijnë nga kati i parë ku ndodhen klasat e para. Në korridor, debatonin me tone të larta dy nëna të fëmijëve në të njëjtën klasë me djalin A.M, me prindin E.M.

U them që “nëse nuk ndaloni do thërras strukturat e policisë”. Të njëjtën gjë thotë dhe punonjësja sociale.

Njëra nga zonjat largohet kurse tjetra, shprehet se “kam ardhur që të shpreh tek SHPS shqetësimin që kam lidhur me djalin tim, sepse dje e kam pasur shumë keq prej situatës në klasë dhe kërkoj zgjidhje të menjëhershme”.

Theksoj se: ky ka qenë takimi im i parë, krejt rastësor (prej faktit se dëgjova tonet e larta të debatit) me një prind tjetër të klasës së I-a, (nëna e nxënësit tjetër nuk kishte ardhur të më takonte mua, por SHPS për të shprehur me shkrim shqetësimin për fëmijën e saj, që ia kishte shprehur psikologes dhe një ditë më parë). Që nga data 17, 22, 23 deri në debatin e prindërve, prindërit e vetëm me të cilët kam kontaktuar kanë qenë prindërit e nxënësit A.M.

U zhvillua një takim me prindin E.M me SHPS, drejtorinë dhe mësuesen e klasës. Gjatë takimit të përbashkët për bashkërendimin e punës, konstatohet se ka kontradiktë mes asaj që thotë prindi E.M dhe asaj që thotë mësuesja.

Gjithsesi, në fund të bisedës me prindin, mësuesja shprehet se nuk është dorëzuar në punën me djalin, kurse babai thotë se dhe ai po ndjek udhëzimet e dhëna nga SHPS.

Njihet ZVAP me rastin.

Rreth orës 14.30, ka qenë nëna që ka folur me mua, jo babai E.M, siç ai pretendon për datën 24 në ankesën e tij, sepse me babain nuk kam pasur më komunikim që kur u ndamë në mëngjes, pas takimit të përbashkët.

Nëna e djalit A.M më thotë se “djalit i është afruar prindi S.H në orën TIK dhe ndihet i trembur”. Kërkon ta flas të nesërmen me mësuesen TIK situatën. Gjithashtu në bisedë e sipër ajo tregon se djali i shprehur se nuk e do mësuesen e tij, se kishte njohje shoqërore me prindin S.H. Kërkoj që asnjë prind të mos hynte në shkollë. U shpreh se për mësimin nuk ka ankesa për mësuesen e djalit, por kërkon më shumë dashuri nga mësuesja për djalin.

Po atë pasdite rreth orës 18.00 të datës 24.10.2024, kryetari i prindërve të klasës më njofton se prindërit duan takim në orën 8.00 për të diskutuar për situatën e krijuar në klasën e fëmijëve të tyre.

Theksoj se mësuesja nuk më kishte vënë në dijeni të situatës në lidhje me prindërit e tjerë deri tani dhe ky ka qenë komunikimi im i parë me një prind nga klasa I-a, në emër të prindërve të klasës, si Kryetar i Këshillit të prindërve të klasës, për të më vënë në dijeni të shqetësimit të tyre.

Datë 25.10.2024. Rreth orës 7.50 vjen babai i djalit E.M, kërkon takim me mësuesen e TIK. I them se “mësuesja nuk është në shkollë sot (premtë), sepse ndjek shkollën e drejtorëve. Do e pyesim se dhe ne duam ta sqarojmë këtë situatë dhe do ju vëmë në dijeni”. E përgëzoj për qetësinë që tregoi në debatin e djeshëm. Prindi takohet me një mësues të shkollës dhe largohet pa më lënë porosi, ashtu si shprehet ai në ankesën e tij.

Theksoj se gjithë javën 21-25.10.2024 ka pasur ndryshime në orar për përshtatjen e orarit për mësuese V.I e cila jep TIK në klasën e djalit A.M, të pasqyruara këto në komunikimet në grupin e telefonit të mësuesve nga sekretaria e shkollës, sepse shkolla e drejtorëve funksionon të premte e të shtunë dhe për këtë arsye i është lënë e lirë dita e premte.

Rreth orës 8.15, të shoqëruar nga nëndrejtoresha AF, disa prindër të klasës, vijnë në drejtori sipas njoftimit të Kryetarit të prindërve. Aty jemi të pranishëm: unë, prindërit, kryetari i prindërve të klasës, nëndrejtoreshat dhe SHPS.

Për herë të parë, personalisht unë si drejtuese e shkollës, prindërve të pranishëm u prezantoj që puna nga ana e shkollës përmes SHPS ka filluar që në datë 22.10.2024 dhe po vazhdon me një plan ndërhyrje në rang klase.

Kryetari i klasës u shpreh se “ata janë përpjekur ta menaxhojnë vetë rastin brenda klasës me mësuesen, nisur dhe nga njohjet shoqërore që ata kanë me prindin E.M”.

Kërkesës që prindërit e pranishëm donin, se si do të ishte zgjidhja, sa e shpejtë do ishte zgjidhja. SHPS u tregoi hapat duke garantuar se përveç punës me djalin, do të punohej dhe me nxënësit e tjerë, si dhe u kërkuam prindërve që të tregohen mirëkuptues dhe bashkëpunues.

Gjithsesi prindërit, edhe pse të shqetësuar për fëmijët e tyre, ranë dakord me procedurën që do të ndiqej nga SHPS duke u treguar të gatshëm edhe për bashkëpunim, por ata kërkojnë që dhe prindërit e nxënësit A.M të jenë bashkëpunues.

Në asnjë moment nuk jam ndjerë në presion nga prindërit (siç shprehet E.M), sepse kam detyrim të kërkojmë bashkërisht zgjidhje për më të mirën e gjithë fëmijëve.

Gjatë orës së dytë, djali acarohet, qëndron poshtë bankës, bërtet, nuk i bindet mësueses. SHPS vazhdon punën.

Rreth orës 9.30 mamaja e djalit më shkruan mesazh për të pyetur për djalin. E sqaroj për djalin. Gjithashtu e vë në dijeni se “E.M sot kërkoi takim me mësuesen e TIK, por ajo nuk është sot se vazhdon shkollën e drejtorëve”.

Kontaktohet nga drejtoria me telefonatë me mësuesen e TIK. Pyetet mësuesja “a ka ardhur ndonjë prind gjatë orës, a i është afruar djalit, a i ka thënë diçka”. Ajo thotë se “Asnjë prind nuk ka ardhur në klasë, as nuk e ka kërcënuar në orën time”.

Nisur nga kërkesa e nënës një ditë më parë, pavarësisht se mësueset që në fillim të vitit ua bëjnë të njohur prindërve Rregulloren, u kërkohet mësuesve ta sjellin sërish në vëmendjen e prindërve, si dhe u kërkohet mësuesve që kanë turnin ditor (dezhurnin) që të forcojnë punën e tyre, edhe për faktin se në shkollë, po bëhen prej disa ditësh punime lidhur me rregullimin e oborrit nga Bashkia.

Rreth orës 14.00, nëna më njofton se një prind tjetër i klasës i është afruar djalit. Nuk më tregon cili prind i është afruar, kohën kur i është afruar. E vë në dijeni se “sot ka pasur prindër në shkollë, por ata kanë qenë të shoqëruar për në zyrën time për takim”. E vë në dijeni dhe për përgjigjen e mësueses së TIK.

Në datë 27 (edhe pse e diel) sërish në komunikim me mësueset u kërkoi forcimin e rregullave në shkollë dhe zbatimin e tyre me përpikmëri nga çdo aktor.

Datë 28.10.2024. Nëna e djalit me mesazh më njofton se djali është i sëmurë dhe nuk vjen. Rreth orës 8.15 në shkollë paraqitet një grup pune nga ZVAP për të ndjekur rastin.

Rreth orës 9.00, më telefonon nëna dhe më thotë se “duam të bisedojmë me ty”. Babai më thotë se, “fëmijës tim i është bërë në klasë filmim, ditën e premte”. Babai thotë se “dua nga ti të gjesh kush e ka bërë”. I them se “Nuk jam në dijeni për këtë gjë. Po e pate filmimin, përderisa thua se djalit i është bërë filmim në klasë, sille të shihet vetëm këndi i klasës nga ku është bërë filmimi, se personin nuk ta gjej dot, ose dërgoje në organet e duhura”.

Theksoj se ky është momenti që prindi E.M më kërkon mua të bëj diçka (pra të gjej kush ka bërë filmim) jo siç shprehet ai për datën 24, në lidhje me prindin S.H. Gjithashtu ai në asnjë moment që nga fillimi nuk ka pranuar të ndajë shqetësimet e tij zyrtarisht, as me mua, as me SHPS.

Datë 29.10.2024, mamaja e djalit me shkruan se “djali refuzon të vijë në shkollë”. I them të vijnë të takojnë SHPS për gjetjen e rrugëve a mënyrave si ta bindim djalin.

Gjatë kësaj dite pyes mësuesen e klasës (meqë vetëm ajo është në klasë dhe mund ta vërtetojë këtë) nëse në klasë i ka bërë filmim dikush djalit. Ajo më tha se “në praninë e saj nuk ka ndodhur asgjë”.

Djali nuk vjen as në datë 30. Komunikimin ma sjell babai. Shprehet se nëse “mund ta sjellë më vonë në mësim djalit, nëse bindet.?” I them “patjetër që po, në çdo kohë. Punonjëset e SHPS

do të jenë në çdo kohë në dispozicion për djalin”. Atë ditë prindi nuk vjen deri sa ne përfundojmë orarin zyrtar.

Datë 31.10.2024. Djali nuk vjen në shkollë. Rreth orës 12 komunikoj me babain. E ftoj të vijë në shkollë të vazhdojmë punën për bashkëpunim. Më thotë se kërkon të dijë “çfarë po bëhet lidhur me atë që diskutuam”.

Theksoj se mësuesja e klasës ka nënshkruar një procesverbal ku deklarohet sigurinë e fëmijës brenda klasës. Procesverbali i mësueses do t’i vihet fizikisht në dispozicion prindit, jo përmes telefonit. E ftoj të vijë të nesërmen.

Datë 1.11.2024. Djali nuk vjen në shkollë. Prindin e prita deri në 13.30, por nuk erdhi.

Datë 4.11.2024. Djali nuk ka ardhur në mësim. Ftoj nënën që të vijë në shkollë të flasim me SHPS, për ndonjë mënyrë si ta bindim djalin.

Niset ftesë zyrtare për bashkëpunim, me postë, në adresë të prindit E.M.

Datë 5.11.2024. Komunikoj me mamën e djalit për të ardhur në shkollë. Ajo thotë se “djali refuzon të vijë në shkollë”. I kërkohet sërish bashkëpunim.

Dërgohet relacioni në DRAP dhe ZVAP.

Datë 6.11.2024. Djali nuk paraqitet në mësim.

Në shkollë vjen përmes postës përgjigjja zyrtare nga grupi i punës ZVAP me detyrat përkatëse, lidhur me ndjekjen e rastit prej tyre në datë 28.10.2024. Mësuesja e klasës njofton nënën e djalit se do të bëjë një vizitë në familjen e tyre bashkë me punonjësen sociale.

Nëna e djalit rreth orës 12, më komunikoi se “djalin e kam regjistruar tek shkolla private Mariff, ndaj nuk është e nevojshme ardhja e tyre”.

Njoftohet koordinatori i SHPS në ZVAP për vendimin e prindit.

Datë 7.11.2024. Relacion për ZVAP drejtuar koordinatores SHPS, mbi ndërhyrjet e realizuara nga drejtoria, mësues, SHPS.

Datë 11.11.2024. Transferimi i nxënësit A.M tek shkolla Mariff në SMIP nga ZVAP”.

Me shkresën nr. 31, datë 16.12.2024, mësuesja e klasës I-a, znj. Sh.B, ka dërguar shpjegime lidhur me trajtimin e shqetësimit të ngritur nga z. E.M dhe masat e marra, ku në mes të tjerash informoi Komisionerin se: “Jam Sh.B mësuese e arsimit fillor në shkollën 9-vjeçare “Sulë Harri”. Këtë profesion e ushtroj prej gati 32 vitesh.

Është rasti i parë që më ndodh një shqetësim i tillë dhe për më tepër nga mikesha ime prej vitesh. Zoti dhe zonja M më kishin zgjedhur të isha unë mësuesja e djalit të tyre pasi kanë qenë të kënaqur me punën time si mësuesja e vajzës së tyre, e për më tepër kanë sugjeruar dhe prindër

të tjerë që të më zgjedhin mua si mësuese për fëmijët e tyre. Ndaj nuk e kam kuptuar arsyen e këtij hakërrimi ndaj meje, duke qenë se unë e kam ndihmuar përtej detyrimeve të mia si mësuese, si nënë apo si shoqe e njohjeve të vjetra familjare.

Për të gjithë fëmijët e klasës së parë fillimi ka vështirësitë e veta, ku më shumë e ku më pak. Javët e para kuptohet janë përshtatje, pasi vijnë nga nivele të ndryshme arsimore, ambient i ri, shokë të rinj, etj. Që në fillim kam qenë e kujdesshme për njohjen e temperamentit të fëmijëve. Për fëmijën në fjalë kisha informacion. E kisha më të lehtë, pasi në biseda miqësore me mamane kur kisha vajzën e tyre nxënëse më thoshte se djali është i llastuar, i plotësojmë çdo dëshirë, është bërë xheloz kur erdhi fëmija tjetër, kërkon shumë vëmendje, do ti shkojë gjithmonë e vetja. Të gjitha këto më ndihmuan për të qenë e kujdesshme me fëmijën. Por shumë shpejt këtyre problematikave iu shtuan dhe problemet shëndetësore. Në javën e tretë fillojnë shqetësimet dhe mungesat.

Me 30 shtator fëmija shfaq sjellje jo të hijshme në klasë. Kontaktet i mbaja çdo ditë me mamane e fëmijës. E marr në telefon, interesohem për fëmijën dhe e ëma më thotë: “Nuk e di çfarë e ka mërzhitur. Që në mëngjes nuk donte të vinte në shkollë”.

Me 1 tetor e ëma merr në telefon në pushim të madh, për të pyetur si është A.Mi. Më thotë “e kam sjellë në shkollë me dhimbje barku”. Vetë prindi kërkon të vijë ta marrë. Më thotë “Mos e lër të bëjë fiskulturë sepse nuk ka qenë mirë me shëndet”. Unë me kërkesë të prindit, për arsye shëndetësore nuk e lashë të bënte fiskulturë. Vjen e merr i ati.

Problemet shëndetësore vazhdojnë. Unë ia përcjell shqetësimin mamasë së A.M, për problemet shëndetësore, si djersitje, kollitje, acarime, shumë i axhituar dhe sjellje jo të hijshme. Në këto raste ndërprisja mësimin dhe punoja me fëmijët për ta kuptuar e falur shokun, duke u ndalur e punuar rregullat e klasës “Ti gjendemi pranë shokut kur nuk ndihet mirë”. E ëma më thotë: “Bëhet i axhituar dhe i acaruar nga solucionet që merr me anë të pompës për problemet shëndetësore”. Këtë informacion unë nuk e dija, nuk ma kishte thënë më parë.

Vetë mamaja e fëmijës më kërkon që kur shfaq këto shqetësime fëmija, unë si mësuese ta telefonoj që ajo të vijë ta marrë. Këtë gjë e kam detyrim ta bëj dhe e kam bërë me çdo fëmijë që nuk ndihet mirë në klasë. Fëmijët tregojnë për axhitimet e A.M (edhe pse unë mundohesha ta qetësoja).

Nuk punonte, nuk bindej të përfundonte detyrën, griste fletët e detyrave të veta dhe të shokëve, hante dhe vizatonte kur donte, duke mos dëgjuar e bindur mësueseve që ishin duke dhënë mësim. Për të gjitha këto kam vënë në dijeni mamane e tij. Bisedoj, informoj kryetarin e këshillit të prindërve të klasës (java e tretë) për shqetësimin dhe menduam ti jepnim kohë. (Me kryetarin e këshillit të prindërve kontaktoja pothuajse çdo ditë për shqetësimet që shfaqeshin)

Kur nuk qetësohej nga ana shëndetësore telefonoja të ëmën (siç ma kishte kërkuar vetë ajo) që të vinte ta merrte, gjithmonë për të mirën e shëndetit të fëmijës.

Me 10 tetor, takohem dhe i ripërcjell shqetësimet që sjell axhitimi i tij. Përgjigja e mamasë së fëmijës është e njëjtë në lidhje me shkakun e axhitimit.

Me datë 14 tetor, e ëma flet nëpërmjet telefonit tim me djalin dhe mundohet ta qetësojë.

Me datë 15 tetor, fëmija nuk ka qenë mirë nga ana shëndetësore ndaj e telefonoj mamamë e tij. Vjen e merr gjyshi. Duke qenë se ajo nuk i përgjigjet dot mbarëvajtjes mësimore të djalit për shkak se ka dhe një bebe të vogël dhe më kërkon për tu konsultuar në mësim me djalin e saj. I përgjigjem ndihmës që kërkon si mikeshë prej shumë vitesh për shkak të njohjeve tona familjare pa asnjë lloj detyrimi. Për të parandaluar largimin nga mësimi (me kërkesë të prindit kur fëmija axhitohej) i kërkoj të bisedojmë se si do të veprojmë në vazhdimësi për raste të tilla, pasi nuk ishte kjo zgjidhja që sa herë axhitohej, unë të telefonoja e ajo të vinte ta merrte.

Ramë dakord që të takoheshim (unë dhe mamaja e fëmijës) pasditen e datës 17 tetor, sepse pas mbarimit të orarit zyrtar të mësimit mamaja e kishte të pamundur të vinte për të biseduar në shkollë duke qenë se kishte një bebe të vogël.

Me datë 17.10.2024, fëmijën e sjell i ati në shkollë. Pa mbaruar ora e parë e mësimit, komunikoj në telefon me mamamë e tij duke i përcjellë shqetësimin shëndetësor të fëmijës. Nuk reagon, atëherë detyrohem të komunikoj me të atin. Edhe atë ditë e ndërpreva mësimin duke u përqendruar te fëmija.

Po atë ditë z. E.M më dërgon një mesazh në orën 09:40 (kur kam qenë në mësim) ndaj nuk i kam kthyer përgjigje. Prindi vjen për të marrë fëmijën. Fëmijën e gjen duke punuar në tabelë bashkë me mua, ashtu siç bëj me çdo fëmijë tjetër. Po mundohesha ta qetësoja duke e vënë në punë dhe duke e pasur tërë kohën vëmendjen tek ai. Fëmija ishte duke vizatuar në tabelë sepse e dëshironte.

Lidhur me pretendimin e z. E.M se djalit të tij i kisha zënë vendin te banka ku ishte ulur një ditë më parë, informoj se e kam praktikë të punës sime ndërrimin e bankave në mënyrë të herë pas hershme dhe të gjithë prindërit janë informuar që në takimin e parë dhe kanë rënë dakord me këtë praktikë, më kanë mirëkuptuar. Për më tepër ky fakt nuk i përket kësaj date por datës 25 tetor.

Ditën që e kishim lënë të bisedonim, pra në datë 17 tetor me mamamë e fëmijës, gjatë orarit mësimor, znj. M kishte kontaktuar me drejtoreshën duke paraqitur si ankesë bezdisjen në telefon nga mësuesja për problemet shëndetësore të fëmijës së vet (kur vetë mamaja e fëmijës e kishte kërkuar). Sa herë kam kontaktuar për problemet e fëmijës me prindërit e tij nuk i kam thënë kurrë për largimin e fëmijës nga klasa apo shkolla.

Nuk kam qenë e nxehur sipas pretendimit të z. M (nuk e di ku më ka parë që kam qenë e nxehur) por e zhgënjyer nga mikeshja ime që përdori shqetësimin tim si të vetin (keqpërdori bisedat dhe komunikimet tona për problemet që kishte fëmija në klasë si pasojë e problemeve shëndetësore, sikurse i justifikonte gjithmonë e ëma të cilat unë i kam marrë të mirëqena pasi vinin të thëna nga

dy mjek) aq më tepër që ne e kishim lënë të flisnim po atë ditë pasdite për të kërkuar ndihmë e për të gjetur një zgjidhje për mbarëvajtjen e fëmijës në shkollë dhe për të mos e bërë unë madhore problematikën, nisur nga ankesat e shumë prindërve. (Gjithashtu i kam referuar se në shkollë ofrohet dhe asistencë e psikologes dhe punonjësit social për të na ardhur në ndihmë, por prindi nuk pranonte ndihmën e psikologut).

Në komunikimin e saj me drejtoreshën ishte vetë ajo që kërkon largimin e fëmijës së vet nga shkolla.

Me datë 18 tetor fëmija nuk vjen në shkollë. Mungoi për arsye shëndetësore.

Lidhur me pretendimin e z. M se prindërit më kanë bërë presion për të larguar djalin e tij nga shkolla nuk qëndron. Përkundrazi ato kanë kërkuar bashkëpunim me prindërit e fëmijës, pasi kryetari i këshillit të prindërve informohej sistematikisht për situatën. Edhe në datë 21 tetor djali mungon në shkollë.

Me datë 22 tetor fillon të monitorojë situatën në klasë shërbimi psiko-social i shkollës.

Lidhur me pretendimin e z. M se mësuesja ka ngritur shqetësimin (dysshime) se fëmija mund të ketë probleme psikologjike nuk është e vërtetë, në asnjë moment nuk e kam ngritur këtë shqetësim. Përkundrazi, edhe kur e ëma ka kërkuar mendimin tim duke më pyetur “Çfarë mendon se mund të ketë djali im?”. Nuk i kam thënë kurrë se ka probleme psikologjike dhe as e kam nënkuptuar.

Masat e marra:

Kam kontaktuar sistematikisht me prindërit e fëmijës. Janë informuar që në momentin e parë kur fëmija ka shfaqur shqetësimet nga problemet shëndetësore. Them e sigurt që e kam mbështetur për problemet shëndetësore e pasojat e saj duke ndërprerë mësimin, duke i qëndruar pranë, duke i dhënë vëmendjen e plotë, duke e veçuar e punuar rregullat e duhura në klasë, sipas rastit. Edhe pse fëmija nuk vinte në shkollë, unë jam interesuar për shëndetin e fëmijës dhe vazhdoja të kërkoja bashkëpunim nga prindi për të biseduar jo me mesazhe, por nga afër, deri vizitë në shtëpi. Për aq kohë sa unë kam qenë në klasë duke zhvilluar mësimin, nuk ka ndodhur asnjë rast që fëmija të jetë cenuar. Zotëroj një raport material ku kam mbajtur shënime për rastin në fjalë”.

Me shkresën nr. 31, datë 16.12.2024, mësuesja e lëndës TIK të klasës I-a, V.I, ka dërguar deklaratën si më poshtë: “Ditën e enjte, datë 24.10.2024, në orën e pestë kam zhvilluar orën e lëndës TIK me klasën I-a, në laboratorin e TIK-ut. Salla e laboratorit të TIK-ut ka një derë hermetike e cila nga jashtë hapet vetëm me kartë (të cilën e disponojmë vetëm unë, mësuesi tjetër i lëndës TIK dhe drejtorja).

E theksova sigurinë e derës për të bërë me dije se në klasë, gjatë orës së mësimi nuk është futur asnjë i jashtëm. Nuk është futur dhe nuk ka shqetësuar fëmijën A.M dhe as fëmijët e tjerë asnjë i jashtëm, ashtu sikurse pretendon prindi E.M.

Ditën e premte datë 25 (kur unë ndodhesha në Shkollën e Drejtorëve në Durrës jam kontaktuar nga drejtoria e jam pyetur nëse është futur ndonjë prind gjatë orës së TIK-ut në klasën I-a, dhe ka shqetësuar nxënësin A.M. I kam deklaruar se në klasë nuk është futur asnjë prind.

Ditën e hënë datë 28.10.2024, jam pyetur sërish nga ZVAP, në drejtorinë e shkollës dhe kam deklaruar sërish: Gjatë orës së mësimi në lëndën TIK, në klasën I-a, zhvilluar në sallën e informatikës, nuk është futur asnjë prind në klasë.

Në datë 31.10.2024 kam bërë deklaratë me shkrim pranë SHPS, ku kam deklaruar sërish të njëjtën gjë.

Jam pyetur për këtë rast dhe nga kolegu i punës A. Xh, shok i prindit, i cili më ka pyetur dhe i kam thënë që nuk u fut asnjë prind në sallën e TIK-ut, gjatë orës së mësimi. Kolegut i kam thënë gjithashtu që ti jepte prindit numrin tim të telefonit, që ta sqaroja për dyshimet që ai kishte, por prindi nuk më ka telefonuar”.

Me shkresën nr. 1797/1, datë 16.12.2024, ZVAP Elbasan, dërgoi dokumentacionin e kërkuar dhe informoi Komisionerin se: “Bashkëlidhur do gjeni dokumentacionin e kërkuar. Përtej materialeve shkresore, drejtuesi i ZVAP ka pasur disa herë biseda telefonike me prindërit e nxënësit, si dhe një takim të drejtpërdrejtë me të dy ata, pranë zyrës së ZVAP-së, ku ndër të tjera, në çdo rast i është ofruar bashkëpunimi dhe garantuar gatishmëria e të gjithë strukturave të arsimit për përmbushjen e detyrës me efektivitet, me qëllim sigurimin e shërbimit cilësor, profesional e pa dallim, si ndaj djalit të tyre, ashtu dhe ndaj cilitdo nxënësi.

Komisioni për verifikimin e problematikës së shfaqur në shkollën “Sulë Harri”, i ngritur nga ZVAP Elbasan, në raportin nr. 1580, datë 28.10.2024, ka rekomanduar se:

- Mësuesja e klasës në bashkëpunim me SHPS, të punojë me prindërit për krijimin e një mjedisi miqësor, midis fëmijëve në klasë, duke mbështetur nxënësin A.M, duke e motivuar dhe stimuluar gjatë orëve mësimore.
- Drejtorisë dhe SHPS të shkollës, i lihet detyrë krijimin e një klime bashkëpunimi për rritjen e mirëqenies psiko-emocionale të fëmijëve në klasë dhe jashtë ambienteve të shkollës.
- SHPS, drejtoria e shkollës dhe mësueset e klasës të hartojnë një plan ndërhyrje të detajuar për strukturimin e sjelljes së nxënësit dhe mirëqenies psiko-emocionale të të gjithë nxënësve në klasë.
- SHPS në bashkëpunim me drejtorin e shkollës, në vazhdimësi të njoftojë me raport të gjitha problematikat e evidentuara gjatë periudhës së implementimit të planit të ndërhyrjes.
- SHPS në bashkëpunim me mësuesen e klasës të hartojnë një plan ndërhyrje për dy javët në vijim. Pas planit të ndërhyrjes, SHPS do të hartojë një raport të detajuar për vazhdimin e trajtimit të rastit”.

Në zbatim të parimit të kontradiktoritetit e transparencës, për një gjykim sa më të drejtë të çështjes, ankuesi nëpërmjet e-mail-it datë 12.02.2025, është njohur me përgjigjet e shkollës dhe ZVAP Elbasan.

- Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, Komisioneri me shkresën nr. 284, datë 10.02.2025 njoftoi, palët për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 19.02.2025, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e palëve në proces.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Seanca dëgjimore u zhvillua me praninë e palëve në proces: ankuesi z. E.M dhe bashkëshortja E.M, dhe palës kundër së cilës është paraqitur ankesa, znj. E.E, Drejtore e shkollës *“Sulë Harri”*, mësuesja e klasës I-a, znj. Sh.B dhe psikologja e shkollës znj. O.Q. Në seancë mori pjesë dhe Drejtorja e ZVAP Elbasan, znj. V.L.

Gjatë seancës dëgjimore, subjekti ankues i qëndroi të njëjtave parashtrime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor dhe me e-mail me KMD-në dhe në mes të tjerash deklaroi se: *“Unë dhe bashkëshortja jemi mjekë dhe e kuptuam se donin ta largonin djalin nga shkolla për arsye të sjelljes së djalit, që prishte orën e mësimet, etj. Ne si prind dënojmë fenomenin mobbing, që do të thotë, mbledhja e të gjithë aktorëve, duke e përjashtuar për një sjellje, duke e bullizuar dhe duke e dërguar si të sëmurë. Mua si prind nuk më është referuar që në fillim që fëmija prish mësimin, këto fenomene erdhën pas datës 30 shtator 2024. Unë nuk kam parë bashkëpunim në këtë çështje, sepse ne u thirrëm pa arsye, se djali po prish orën e mësimet, duke e lënë shumë herë djalin vetëm në bankë, ndryshimi shpesh i bankës pa arsye, prezenca e prindërve të tjerë në klasë pa arsye. Unë jam përballur me prindërit e tjerë, kur kam debatuar në korridor me prindin që qëndronte në klasë për sjelljen e fëmijës së tij, dhe mua mu kërkua që të qëndroj në klasë, por nuk e pashë të arsyeshme, se unë e dorëzoja fëmijën në klasë të qetë.*

Dy prindër që kanë rol kryesor në klasë, njëri kryetari i këshillit të prindërve të klasës dhe tjetra anëtare, më thanë për çështjen e videos që qarkullonte në shkollë. Një prind A.Sh, ka takuar bashkëshorten dhe i thotë se i është bërë një video fëmijës. Takova kryetarin e këshillit të prindërve K.Xh dhe më thotë se i është bërë një video djalit (datë 24-25) dhe prindërit e klasës kanë bërë një mbledhje, ku unë nuk isha. Unë nuk e di kush e ka bërë videon.

Para datës 30 shtator, nga klasa është larguar dhe një fëmijë tjetër, po për të njëjtat fenomene dhe mua si prind na kërkonin që të paraqiteshim dhe të shkonim në drejtori për këtë çështje. Unë nuk u bëra palë asnjëherë se nuk e pashë të arsyeshme, pasi nuk jam unë rregullatori i kësaj çështje por është institucioni.

Unë nuk kam pasur dhe nuk kam problematikë me mësuesen Sh.B, unë i referohem fenomenit.

Znj. E.M deklaroi: *Komunikimi me mësuesen ka qenë i përditshmëm, sepse e kam pasur shumë mikeshë. Fëmija një ditë ka qenë i sëmurë dhe i kam thënë mësueses se sot djali mund të mos jetë mirë dhe mund të jetë i axhituar nga ilaçi, dhe pompa mund të jetë përdorur 2-3 herë, por nuk është pompë kronike, është pompë joazmatike që nuk ka lidhje me axhitimin. Djali ka një tip që nëse një situatë nuk i pëlqen, dikush e trajton jo si duhet, e ngacmon, aty reagon keq. Djali dhe tashti thotë që nuk e dua më atë shkollë. Në shkollën ku është tashti, djali nuk ka asnjë problematikë, është i lidhur me mësuesen dhe do të shkojë në shkollë”.*

Gjatë seancës dëgjimore, drejtuesja e shkollës “Sulë Harri”, i qëndroi të njëjtave parashtrime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në, ndërkohë që në mes të tjerash deklaroi² se: *“Jam njohur me shqetësimin e nënës së djalit në datë 17.10.2024, lidhur me sjelljen e mësueses, e cila kishte 2-3 ditë që e merrte në telefon dhe i thoshte të merrte djalin për arsye të sjelljes së acaruar të tij. I them që në mëngjes takova babain (rreth orës 09.10) dhe më shprehu që djali ishte pa qejf dhe nuk shprehu asnjë lloj shqetësimi. Po atë ditë njoftoj nëndrejtoreshen e arsimit fillor, që të njoftojë mësuesen që pas mësimit të takoheshim. Mësuesja tha që e kishte lënë pasdite për të takuar mamanë e djalit dhe nuk është e vërtetë që e ka marrë për sjelljen, por vetë nëna i ka thënë që fëmija është sëmurë dhe ta njoftojë se fëmija ka disa ditë që është me djersë, kollë dhe kjo është arsyeja që e ka thirrur. Duke parë që kishte qëndrime të ndryshme mes prindit dhe mësueses, e marr në telefon nënën e djalit dhe i them që të bëjmë një takim, aq më tepër që pashë reagimin, që nuk donte këshillimin psiko-social dhe më thotë që do vijmë pas dy ditësh. Në datë 18 dhe 21 fëmija nuk ishte në shkollë. Në datë 22 vjen prindi dhe më thotë se ne si prind, nisur nga situata bëme një vlerësim tek mjeku dhe i them se ne nuk të kemi thënë të bësh vlerësim nga jashtë, por të bisedojmë me shërbimin psiko social dhe mësuesen, për të mirën e fëmijës. Sapo mora dijeni për rastin njoftova shërbimin psiko social dhe ata filluan punën, duke vëzhguar mësimin në klasë dhe hartojnë relacionin paraprak. Në datë 22 deri datë 25, u bë vëzhgimi psiko social. Deri në datë 22.10.2024, nuk kemi qenë në dijeni të shqetësimit të prindërve, se nuk ishte bërë i njohur nga mësuesja, e cila kishte diskutuar me kryetarin e këshillit të prindërve. Shqetësimin për sjelljen e djalit ma bëri prezent në datë 23 dhe mësuesja e anglishtes, e cila më thotë se djali ka nxerrë ushqimin, tregohet i pabindur, lëviz dhe përplas bankat.*

Ditën e premte datë 25, u zhvillua një takim me këshillin e prindërve të klasës, sepse ishin të shqetësuar për situatën në klasë. U takuam dhe folëm për shqetësimin e tyre. Ne si shkollë i parashtruam se si do të vepronte shkolla dhe shërbimi psiko social dhe ata do punonin me fëmijët e tyre, që të ndikonin me sjelljen e tyre për qetësinë në klasë. Prindin e A.M nuk e kishin thirrur se donin takim vetëm me shkollën. Në datë 28 vjen një grup pune nga ZVAP Elbasan, sepse unë e referova rastin atje.

Unë i kam thënë prindit që më sill videon të shohim këndin nga është bërë, ndërsa mësuesja e TIK ka mbajtur procesverbal, që asgjë nuk ka ndodhur ditën e premte, në klasë, lidhur me videon. Në datë 6 nëntor vjen kërkesa nga ZVAP për transferimin e djalit në një shkollë tjetër dhe në datë 11 nëntor është bërë transferimi me sistemin SMIP.

² Referuar deklarimeve të bëra gjatë seancës dëgjimore, min 57.28, e në vijim.

Unë nuk kam dijeni për arsyet e transferimit të fëmijës tjetër, sikur u deklarua nga z. M, se i kanë bërë presion prindërit e tjerë për tu larguar, por kam një kërkesë nga prindi për transferim në një shkollë private dhe nuk kam pasur ankesë nga prindi për mësuesen Sh.B”.

Gjatë seancës dëgjimore, mësuesja znj. Sh.B i qëndroi të njëjtave parashtrime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në dhe në mes të tjerash deklaroi³ se: *“Në pamundësi për të ardhur nëna e djalit, sepse ka një fëmijë të vogël, kontaktonim vazhdimisht me telefon, pasi kishim njohje të vjetër. Nga përvoja ime 30 vjeçare si mësuese, duke e ditur që fëmijëve i duhet rreth 3-4 javë që të përshtaten, unë i dhashë kohë përshtatjes së fëmijës. Unë personalisht kam menduar që ishte herët akoma për të kërkuar ndihmën e psikologut për rastin, sepse sipas përvojës sime, fëmijët janë shtruar dhe deri në janar dhe prandaj e kisha lënë që të takohesha me prindërit e djalit për ta biseduar situatën, ndërkohë që atë ditë nëna e fëmijës kishte komunikuar me drejtoreshën.*

Në momentin që u zgjodh këshilli i prindërve të klasës, shqetësimet ia kam përcjellë kryetarit të këshillit të prindërve”.

Gjatë seancës dëgjimore, psikologja e shkollës znj. O.Q, në mes të tjerash deklaroi⁴ se: *“Për rastin në fjalë, i kemi propozuar babait të A.M që të marrim miratimin e informuar për dhënien e shërbimit individualisht dhe nuk e ka miratuar, më ka dhënë aksesin për të ndërhyrë në klasë dhe për të asistuar dhe menaxhuar rastet kur fëmija të ketë shpërthime emocionale. Dinamikën në klasë e rregullon mësuesi. Kam marrë kontakt dhe me mësuesit e tjerë dhe mësuesja e anglishtes më ka evidentuar problematika në lidhje me menaxhimin e sjelljes së djalit, mësuesja e TIK më ka referuar vetëm me datë 24 që ishte i axhituar, ndërsa mësuesi i edukimit fizik nuk më ka referuar asnjë problematikë”.*

Në vijim të seancës dëgjimore, shkolla “Sulë Harri” me email-in datë 24.02.2025, ka dërguar dokumentacionin e kërkuar gjatë seancës dëgjimore.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë dhe të pafavorshëm të nxënësit A.M, i përfaqësuar nga prindi z. E.M, nga ana e Shkollës 9-vjeçare “Sulë Harri”, Elbasan.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 1 sipërcituar dhe nenin 3/1, parashikojnë se: *“‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

³ Referuar deklarimeve të bëra gjatë seancës dëgjimore, min 01.05.00, e në vijim.

⁴ Referuar deklarimeve të bëra gjatë seancës dëgjimore, min 01.58.20, e në vijim.

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e subjektit për trajtim të padrejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”*.

LMD, i ndryshuar, në nenin 32/2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacionin në përmbushjen e detyrave të tij”*.

Nga këqyrja e dokumentacionit, deklarimeve të palëve dhe kronologjia e ngjarjeve dhe fakteve rezulton se:

Nxënësi A.M, për vitin shkollor 2024-2025, është regjistruar në klasën e I-a, në shkollën “Sulë Harri”, Elbasan.

Nga deklaratimet e palëve gjatë komunikimit shkresor dhe seancës dëgjimore, rezulton se prindërit e fëmijës dhe mësuesja Sh.B, kanë pasur njohje të afërta dhe kanë komunikuar në vijimësi, që nga fillimi i vitit shkollor, lidhur me mbarëvajtjen në klasë të fëmijës A.M. Gjatë kësaj periudhe, nga dita e parë e shkollës deri në datë 17.10.2024, pranohet nga ty dyja palët, (prindërit dhe mësuesja) se kanë komunikuar në mënyrë të rregullt, gati të përditshme lidhur me sjelljen, gjendjen shëndetësore dhe ecurinë e fëmijës në klasë.

Referuar procesverbalit datë 18.09.2024, të mbajtur nga Kryetari i Këshillit të Prindërve të klasës së I-a, z. K.Xh, rezulton se në datë 18.09.2024, është zhvilluar një mbledhje e prindërve të nxënësve të klasës me mësuesen, e cila i ka njohur me rregulloren e brendshme të shkollës, mbështetjen që ofron shkolla nëpërmjet shërbimit psiko social (SHPS) dhe ka kërkuar nga prindërit që të punojnë me fëmijët për sjelljen që duhen të kenë në klasë, gjatë zhvillimit të procesit mësimor.

Në nenin 54, të ligjit nr. 69/2012 *“Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”*, të ndryshuar, parashikohet se drejtori i institucionit arsimor: *“1. Drejtori drejton veprimtarinë e institucionit arsimor. 2. Drejtori i institucionit arsimor, publik ose privat, është përgjegjës për: a) zbatimin e këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij; b) c)..... ç).....”*.

Në nenin 62 të ligjit 69/2012, të ndryshuar, parashikohet se: “Të drejtat dhe detyrat e prindërve: 2. Prindi ka të drejtë: a) të informohet nga institucioni arsimor përkatës për legjislacionin arsimor në fuqi, për rregulloren e institucionit dhe për kurrikulën që institucioni i ofron fëmijës së tij; b) c) të informohet për veprimtarinë e fëmijës së tij në institucion dhe të japë pëlqim për veprimtaritë plotësuese dhe jashtëshkollore që organizon shkolla;..... 3. Prindi ka detyrë: a) të kujdeset që fëmija i tij të ndjekë rregullisht institucionin arsimor dhe të mësojë rregullisht; b) të njoftojë për ndryshime të shëndetit dhe të sjelljes së fëmijës së tij; c) të marrë pjesë në takimet për që kanë të bëjnë me fëmijën e tij;”.

Në zbatim të ligjit për arsimin parauniversitar, Ministria e Arsimit dhe Sportit me Urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020, ka miratuar Rregulloren për Funksionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare.

Në Rregulloren e sipërcituar parashikohet si më poshtë:

Neni 56; 2. Mësuesi ka për detyrë: c) të trajtojë këdo, në mjediset e IA-së, me respekt, me dinjitet, në mënyrë të kulturuar dhe të moralshme, pa presione, pa padrejtësi, pa fyerje, pa diskriminim, pa dhunë; ç) të përkujdeset për mbarëvajtjen e çdo nxënësi të tij; dh) të kërkojë të shqyrtohen në drejtorinë, këshillin e mësuesve, këshillin e prindërve dhe bordin e institucionit çështje që shqetësojnë cilësinë e shërbimit arsimor në institucion; ...

Neni 67; 2. Mësuesi kujdestar ka për detyrë: a) të informojë rregullisht personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore rreth mbarëvajtjes së fëmijëve të tyre; b) të takojë me përparësi personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të nxënësve me vështirësi në të nxënë, me sjellje shqetësuese ose me probleme në ndjekjen e shkollës;

Referuar procesverbalit të mbajtur në datë 27.09.2024, mes mësueses Sh.B dhe Kryetarit të Këshillit të Prindërve z. K.Xh, rezulton se kanë diskutuar lidhur me shqetësimin që kishte nisur në klasë nga sjellja e nxënësit A.M dhe kanë menduar se duke qenë se është fillimi i shkollës, ti jepnin kohë nxënësit për përshtatje me ambientin dhe shokët e rinj.

Referuar shënimeve të mbajtura nga mësuesja Sh.B, në datat 27 dhe 30.09.2024, dhe datat 01, 02, 03, 14, 17.10.2024, rezulton se mësuesja kishte komunikuar me telefon me nënën e djalit, duke i referuar ecurinë e djalit në klasë, lidhur me sjelljen dhe gjendjen shëndetësore, pasi gjatë këtyre ditëve djali kishte shfaqur sjellje që shqetësonte fëmijët e tjerë dhe ndikonte në zhvillimin normal të procesit mësimor.

Referuar deklarimeve të palëve gjatë seancës dëgjimore, rezulton se prindërit e fëmijës dhe mësuesja e klasës, kishin biseduar që nëse djali do kishte probleme të shëndetit, të lajmëroheshin që ta merrnin djalin nga shkolla.

Referuar deklarimeve të palëve, rezulton se në datë 17.10.2024, nëna e djalit nëpërmjet telefonit, ka vënë në dijeni drejtoreshën e shkollës, se mësuesja e djalit prej 3-4 ditësh e lajmëron me telefon dhe i kërkon që ta marrë djalin nga shkolla, pasi djali shfaq sjellje problematike në klasë. Po atë

ditë, drejtorja e shkollës ka marrë kontakt me mësuesen e klasës dhe ka vendosur që ditën e nesërme, të zhvillojë një takim mes mësueses dhe prindit të fëmijës, takim i cili nuk është zhvilluar. Në datë 18 (premtë) dhe 21 tetor fëmija ka munguar në shkollë.

Në Rregulloren për Funksionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare, parashikohet si më poshtë:

“Neni 29. 1. Shërbimi psiko social vlerëson gjendjen psiko sociale të nxënësve me probleme të të nxënësve ose të sjelljes dhe në bashkëpunim me mësuesit, me drejtuesit e IA-ve dhe personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të nxënësve, planifikon e realizon shërbime të përshtatshme që ndihmojnë zhvillimin arsimor, social dhe personal të nxënësve. 2..... 3. Shërbimi psiko social mbështet personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të nxënësve dhe bashkëpunon me ta për zgjidhjen e situatave dhe në raste nevojë të kërkuara prej tyre.

Neni 31. Psikologu/punonjësi social ka këto detyra kryesore në institucionin arsimor: 1. Identifikon e vlerëson, sa më herët, në bashkëpunim me mësuesit dhe personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore, nxënësve me probleme të sjelljes ose me vështirësi në të nxënë dhe harton e zbaton për këta nxënës plane individuale parandaluese ose rehabilituese;

Neni 42; 1. Drejtori i IA-së është titullari i institucionit, që ka drejtën e firmës dhe vulës së institucionit. 2. Drejtori, kur mungon përkohësisht, i delegon me shkrim njërit prej nëndrejtorëve ose një mësuesi të institucionit, kur nuk ka nëndrejtor, duke saktësuar kompetencat e deleguara dhe afatin e delegimit si dhe njofton ZVA-në për këtë delegim. 3. Drejtori ka përgjegjësi zbatimin në IA të kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi. 4. Drejtori ka përgjegjësi administrative si dhe penale, në rastet e parashikuara nga ligji, për plotësimin, brenda afateve kohore, të amzës, indeksit të amzës, regjistrimit të veçantë dhe të çdo dokumenti shkollor. 5. Drejtori ka përgjegjësinë për krijimin në institucion të klimës së bashkëpunimit dhe respektit ndërmjet punonjësve arsimor në institucion. 6. Drejtori krijon mundësi bashkëpunimi të IA-së me institucionet publike dhe private, brenda dhe jashtë vendit, dhe me institucionet analoge. Pas shqyrtimit të këtyre bashkëpunimeve në këshillin e mësuesve, drejtori i IA-së publike merr miratimin për to nga titullari i ZVA-së përkatëse. Në rastet kur organizatat jopublike apo persona të tjerë juridikë kërkojnë të ushtrojnë veprimtari në ambientet e IA-së, merret miratimi paraprak i ministrit. 7. Drejtori ka përgjegjësi për zbatimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit të lidhurar nëpërmjet ministrit dhe institucioneve/palëve të tjera. 8. Drejtori merr masa për të siguruar ndjekjen e shkollës nga nxënësve e arsimit bazë, që i përkasin zonës së shkollës. Drejtori i IA-së publike të arsimit bazë me kohë të plotë bashkëpunon me NjMF-në, këshillin e prindërve të shkollës dhe këshillat e prindërve të klasave, qeverinë e nxënësve, me shërbimin psiko-social dhe me bordin e shkollës për të siguruar ndjekjen e shkollës nga nxënësve.

Në zbatim të rregullores sipërcituar, drejtoresha e shkollës në datë 22.10.2024, ka vënë në dijeni shërbimin psiko social të shkollës, të cilët po atë ditë kanë hartuar, planin e ndërhyrjes në rang klase, lidhur me klimën e tensionuar në klasë, të krijuar nga nxënësi A.M dhe reagimeve të nxënësve të tjerë kundrejt nxënësve.

Shërbimi psiko social i shkollës, me shkresën nr. 17, datë 24.10.2024, ka hartuar relacionin për rastin e shqyrtuar. Në mes të tjerash në këtë relacion SHPS ka informuar se: *“Në datë 22.10.2024 kemi realizuar vëzhgimin e fëmijës në klasë, nga ku është konstatuar se nxënësi A.M nuk ndjek mësimin, dëshiron të bëjë aktivitetet që do në klasë, ka momente që shpërthen duke bërë titur dhe duke i grisur shokëve detyrat. Është qetësuar fëmija kur ka bërë këtë sjellje pasi pas tij fëmijët kanë filluar të qajnë dhe është ndërhyrë duke bërë një lojë psikosociale për të ndryshuar dinamikën dhe klimën e krijuar. Në datë 23.10.2024 është vëzhguar fëmija A.M. Në orën e parë ka qenë i qetë, në orën e dytë mësimore ka shfaqur shqetësime sipas referimeve të mësueses së anglishtes nga ku ka bërë titur në klasë, nuk ka ndjekur mësimin, ka prishur klimën në klasë disa herë. Në orën e tretë nuk është qetësuar, ka bërë titur në klasë, është ngritur dhe u ka grisur fëmijëve detyrat, ka përplasur karrigën në tokë dhe ka marrë lapsin të godasë fëmijët..... Është telefonuar prindi dhe pas largimit me fëmijën për realizimin e takimit në shkollë, ka informuar që nuk mundet dhe do të vijë të nesërmen në mëngjes. Prindër të klasës I-a në oborrin e shkollës kanë kërkuar zgjidhjen e menjëhershme të situatës dhe janë informuar se çështja po trajtohet nga shërbimi, pasi sapo jemi vënë në dijeni. Në datë 24.10.2024 është realizuar një takim me prindin e nxënësit A.M, në prani të shërbimit psiko social, drejtoreshës, nëndrejtoreshës dhe mësueses së klasës nga ku është paraqitur e gjithë situata. Në këtë takim i është kërkuar prindit dhënia e Miratimit të Informuar për ndërhyrjen me fëmijën, por prindi ka rrefuzuar si një e drejtë e tij si kujdestar ligjor dhe se ka kërkuar ndërhyrjen dhe bashkëpunimin e shërbimit në dhënien e shërbimit në klasë. Është kërkuar bashkëpunimi me prindin i cili ka pranuar dhe bashkëpunimin me mësuesen, për menaxhimin e situatës dhe sjelljes së nxënësit. ...”*

Sipas procesverbalit datë 25.10.2024, rezulton se në shkollë, atë ditë është zhvilluar një takim me prindërit e nxënësve të klasës I-a, të cilët kanë shprehur shqetësimet e tyre për situatën e sjelljes së dhunshme të nxënësit A.M në klasë dhe në përfundim kryetari i këshillit të prindërve të klasës ka kërkuar nga shërbimi psiko social që të mbanin në vëzhgim klasën, për prishjen e orëve të mësimin.

Pas vënies në dijeni nga drejtoria e shkollës “Sulë Harri” dhe nga prindi z. E.M, për shqetësimin objekt shqyrtimi, ZVAP Elbasan, me Urdhrin nr. 108, datë 28.10.2024, ka ngritur grupin e punës për verifikimin e problematikës në shkollën “Sulë Harri”.

Grupi i punës i ngritur nga ZVAP Elbasan, pas takimeve me drejtuesit e shkollës, mësuesit që japin mësim në klasë, bisedave me prindër, bisedave me fëmijët dhe rezultatet e pyetësorit, me shkresën nr. 1580, datë 28.10.2024, ka hartuar raportin për problematikën e trajtuar. Në përfundim të raportit grupi i punës në mes të tjerash ka rekomanduar se: - *Mësuesja e klasës në bashkëpunim me SHPS të punojë me prindërit për krijimin e një mjedisi miqësor, midis fëmijëve në klasë, duke mbështetur nxënësin A.M, duke e motivuar dhe stimuluar gjatë orëve mësimore. – Drejtorisë dhe SHPS të shkollës i lihet detyrë krijimi i një klime bashkëpunimi për rritjen e mirëqenies psiko-emocionale të fëmijëve në klasë dhe jashtë ambienteve të shkollës. – SHPS, drejtoria e shkollës dhe mësueset e klasës të hartojnë një plan ndërhyrje të detajuar për strukturimin e sjelljes së nxënësit dhe mirëqenies psiko-emocionale të të gjithë nxënësve në klasë.*

Me Relacionet datë 05.11.2024 dhe datë 07.11.2024, SHPS i shkollës “Sulë Harri” ka relatuar situatën dhe veprimet e ndërmarra lidhur me trajtimin e rasti, nga data 22.10.2024 deri në datë 07.11.2024. Në relacionin datë 05.11.2024, SHPS ka trajtuar dhe shqetësimin e prindit E.M lidhur me kërcënimin/videon e bërë djalit të tij nga ana e një prindi. Lidhur me këtë në relacion informohet se: *“Kemi marrë informacion si shërbim nëse fëmija është kërcënuar apo filmuar nga ndonjë person, nga mësuesja e TIK dhe mësuesja kujdestare sipas shqetësimit që prindi ngre dhe mësueset nuk referojnë asnjë problematikë të kësaj natyre. Është vënë në dijeni dhe drejtoria për këtë problematikë. Në cilësinë e SHPS është marrë kontakt nëse ka ndodhur ndonjë episod që mund të ketë trembur fëmijën në klasë, por mësuesja është shprehur që gjatë kohës që ka dhënë mësim nuk ka ndodhur asnjë gjë që mund të cenojë fëmijën”*.

Lidhur me këtë pretendim të ankuesit, nuk rezulton asnjë provë që kjo ngjarje të ketë ndodhur në mjediset e shkollës. Mësuesja Sh.B dhe mësuesja e TIK, me anë të procesverbaleve të mbajtura në datë 31.10.2024, kanë deklaruar se nuk ka ndodhur asnjë rast që fëmija A.M të jetë cënuar, gjatë kohës që ato kanë qenë në mësim.

Referuar dokumentacionit të shqyrtuar, rezulton se fëmija A.M, nga data 28.10.2024 nuk është paraqitur më në shkollë dhe prindi i fëmijës në datë 06.11.2024, ka njoftuar drejtorinë dhe mësuesen, që si prindër kanë marrë vendimin për transferimin e fëmijës në një shkollë tjetër dhe në datë 11.11.2024 është kryer transferimi i fëmijës në një shkollë tjetër, nëpërmjet sistemit SMIP.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, shkolla “Sulë Harri” ka zbatuar legjislacionin e sipërcituar, i detyrueshëm për institucionet arsimore, duke shqyrtuar dhe trajtuar rastin sipas fakteve dhe provave të grumbulluara nga palët, nëpërmjet shërbimit psiko social të shkollës dhe duke kërkuar në vijimësi dhe bashkëpunimin e ankuesit dhe prindërve të klasës, për mbarëvajtjen e procesit mësimor në klasë.

Diskriminimi përkufizohet në nenin 3, pika 1 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si nga ligjet në fuqi”*.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7/1 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se Shkolla 9-vjeçare “Sulë Harri”, Elbasan kanë zbatuar

legjislacionin e sipërcituar, i detyrueshëm për institucionet arsimore dhe se nuk kanë ndërmarrë veprime që kanë ekspozuar fëmijën e subjektit ankues ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm.

Në mungesë të këtij trajtimi, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje të paligjshme nga ana e këtyre institucioneve, për shkakun e pretenduar nga ankuesi dhe për rrjedhojë nuk provohet se Shkolla “Sulë Harri”, ka shkelur dispozitat e ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenet 32 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të nxënësve A.M, i përfaqësuar nga babai E.M nga ana e Shkollës 9-vjeçare “Sulë Harri”, Elbasan.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA